



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR

Nr. _____ Prot

Shkodër, më _____._____.2025

Lënda: Kthim përgjigje

Në vijim të interesimit mediatik mbi fondin e emergjencave civile dhe mbështetjen financiare për familjet e prekura nga fatkeqësitë natyrore, referuar pyetjeve të parashtruara, paraqesim përgjigjet zyrtare si më poshtë:

1. Pyetje:

Sa është fondi i përcaktuar për familjet që kanë përfituar nga fondi i emergjencave civile, për shkak të fatkeqësive natyrore si tërmetet, zjarret dhe përmbytjet, gjatë 6 viteve të fundit (2019–2025)?

Përgjigje: Fondet e Emergjencave civile janë cdo vit te publikuara ne faqen zyrtare te Bashkisë Shkoder

Për vitin 2025, fondi total i akorduar për dëmshpërblimin e familjeve të dëmtuara nga zjarret është **15,907,271 lek**

2. Pyetje:

Sa nga ky fond i përcaktuar është shpërndarë?

Përgjigje:

Deri në fund të vitit përkatës, fondi i akorduar do të **shpërndahet plotësisht**.

3. Pyetje:

A është përcaktuar një afat për shpërndarjen e pjesës së pashpërndarë të fondit?

Përgjigje:

Çdo vit parashikohet një fond i ri, i bazuar në statistika dhe në regjistrin e riskut, për këtë arsye **nuk rezulton të ketë fond të pashpërndarë**.

4. Pyetje:

Sa familje janë identifikuar si të dëmtuara dhe sa prej tyre kanë përfituar nga ky fond?

Përgjigje:

Janë identifikuar gjithsej **26 familje** si të dëmtuara per vitin 2025. Nga këto, **20 familje kanë përfituar mbështetje financiare**, ndërsa **6 familje pritet të përfitojnë deri në fund të vitit**, pasi janë ende në proces të përfundimit të procedurave.

5. Pyetje:

Cilat janë bashkitë që kanë pasur numrin më të lartë të rasteve?

Përgjigje:

Ky informacion **nuk disponohet aktualisht** nga ana e institucionit tonë.

K R Y E T A R

Benet BECI